

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga shoqëria Generali IARD me seli në 2 Rue Pillet – Vill Paris, 75009 Francë dhe Generali Vie me seli në 2 Rue Pillet – Vill Paris, 75009 Francë, dorëzuar përmes Shoqatës së Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën mbajtur më 15.03.2022, solli

### AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Generali Iard me seli në 2 Rue Pillet – Vill Paris, 75009 Francë do të fitoj kontrollin e vetëm mbi La Medikale me seli të regjistruar në 3 Rue Saint Viusent de Paul 75010 Paris, Francë me anë të shitblerjes së aksioneve dhe Generali Vie me seli të regjistruar në 2 Rue Pillet – Vill Paris, 75009 France do të fitoj një portofol të mbulimit në rast të vdekjes dhe një mbulim për humbjen e pakthyeshme të autonomisë e cila është e siguruar nga Predika Prevojance, Dialogue du Kredit Agrikole me seli të regjistruar në bulevardin de Vaugirard 16-18, 75015 Paris, Francë, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligjit), më 09.02.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga shoqëria Generali IARD me seli në 2 Rue Pillet – Vill Paris, 75009 Francë dhe Generali Vie me seli në 2 Rue Pillet – Vill Paris, 75009 Francë, ku Generali Iard do të fitoj një portofol të mbulimit në rast të vdekjes dhe një mbulim për humbjen e pakthyeshme të autonomisë e cila është e siguruar nga Predika Prevojance, Dialogue du Kredit

Agrikole me seli të regjistruar në bulevardin de Vaugirard 16-18, 75015 Paris, Francë, të përfshira në policat e sigurimit të komercializuara nga La Medikale.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

**Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

Generali IAR dhe Generali Vie janë shoqëri të varura në pronësi të plotë të Generali Francia, gjegjësisht të Assukuracioni Generali S.p.A.

Generali Francia është aktive në sektorin e sigurimeve dhe në veçanti në tregjet e mëposhtme:

- tregun francez për ofrimin e produkteve të sigurimit të jetës dhe segmenteve të tij, nëpërmjet Generali Vie;

- tregun francez për sigurimin e jo-jetës, nëpërmjet Generali IARD dhe në një masë më të vogël përmes shoqërive të varura të tij L'Ekuite, GFA Karaibes dhe Prudence Kreole.

Generali Francia është aktiv në të gjitha nën-segmentet që janë parashikuar nga Komisioni Evropian;

- tregu francez për shpërndarjen e produkteve të sigurimit. Generali France shpërndan drejtpërdrejt dhe indirekt produktet e saj. Shitjet direkte kryhen nga subjektet e përmendura më sipër (p.sh. Generali Vie dhe Generali IARD dhe në një masë më të vogël L'Ekuite, GFA Karaibes dhe Prudence Kreole).

Generali Francia është një nga lojtarët kryesorë në botë në sektorin e sigurimeve dhe menaxhimit të mjeteve. E themeluar në 1831, Grupi Generali është i pranishëm në 50 vende.

Në tregun e sigurimeve, Grupi Generali është një lojtar global në industrinë e sigurimeve, duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve të sigurimit, që mbulojnë sigurimin e jetës dhe sigurimin e pronës dhe dëmet e klientëve, duke filluar nga kursimet, policat individuale dhe familjare, policat që lidhen me gjëra të caktuar, si dhe sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta në trafik, pronë, aksidente dhe policat shëndetësore. Oferta e sigurimit e Grupit Generali përfshin mbulim të sofistikuar për rreziqet tregtare dhe industriale dhe plane të personalizuara për kompanitë shumëkombëshe. Grupi Generali ka një strategji të shpërndarjes me shumë kanale të përbërë nga një rrjet ndërkombëtar agjentësh dhe këshilltarësh financiarë, ndërmjetësve, sigurimit bankar dhe kanaleve të drejtpërdrejta telefonike dhe ueb.

Në tregun e menaxhimit të mjeteve, Grupi Generali është aktiv në tre fusha kryesore:

- Menaxhim i investimeve: zbatim i modeleve të menaxhimit me përgjegjësi të mjeteve (ALM) dhe alokimit strategjik të mjeteve (SAA) për shoqëritë e sigurimit të Grupit Generali;
- Menaxhim i mjeteve: shërbimet për menaxhimin e mjeteve që synojnë kryesisht klientët e sigurimeve, me synimin për të zgjeruar bazën e klientëve tek klientët e palëve të treta, si dhe institucionale (si fondet e pensioneve dhe fondacionet) dhe shitja me pakicë;
- Menaxhim i pasurisë: shërbimet e këshillimit financiar dhe mbrojtjes së pasurisë që u ofrohen klientëve privatë.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Generali ka një prani të regjistruar të korporatës përmes shoqërisë së tij të varur:

-Shoqëria për menaxhimin e fondeve të investimeve GENERALI INCEVSTEMTS SHA Shkup me seli në bul. Partizanski Odredi nr. 14A-1/2 Shkup-Qendër, e cila është aktive në sektorin e menaxhimit të fondeve të investimeve.

-La Medikale është një kompani e specializuar në sigurimin e punonjësve shëndetësorë. La Medikale është aktive në Francë dhe Monako.

La Medikale ofron vetëm sigurim jo-jetë dhe fokusohet në sigurimin e përgjegjesisë mjekësore.

Përveç sigurimit të përgjegjesisë mjekësore, Shoqëria e Synuar ofron edhe produktet e mëposhtme të sigurimit:

- lëndime personale;
- mjet motorik;
- pronë;
- përgjegjësi;
- sigurim juridik.

La Medikale nuk është e licencuar për të ofruar sigurimin e jetës. Megjithatë, si pjesë e aktivitetit të saj, La Medikale shpërndan produkte të sigurimit të jetës nga Predika Kali dhe Spirika, shoqëri varura të tjera të CAA-së, dhe veçanërisht produktet e kursimit dhe produktet e investimeve

- La Medikale nuk ka prezencë të regjistruar korporative dhe as nuk është aktive në ndonjë treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

## **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**